



Prill 2021

Vaksina e koronavirusit në Hamar

Komuna e Hamarit ju ofron vaksinën kundër Covid-19 për të gjithë ata që banojnë në Hamar. Vaksina e koronavirusit është falas.

Vaksina është gjëja më e rëndësishme për me e ndalue pandeminë. Prandaj autoritetet shëndetësore në Hamar kërkojnë nga të gjithë banorët që të vaksinohen.

Në çfarë mënyre do të vini deri te marrja e vaksinës?

Ju duhet të regjistroheni në mënyrë dixhitale për të hyrë në rendin e vaksinës dhe regjistrohuni në këte faqe të internetit www.hamar.kommune.no/koronavaksine ose me anë të telefonit 62 56 32 00 (nga e hëna deri të premten prej orës 9-15).

Rezervoni termin

Kur është rendi i juaj, e merrni një mesazh nga “Helseboka” i cili ju tregon se ju mund të rezervoni termin për vaksinim. Ju e zgjidhni terminin duke klikuar në linkun ose duke e thirrur numrin e telefonit i cili gjendet në mesazh.

Juve ju caktohen terminet për 2 doza. Është me rëndësi të jeni prezent në dy terminet e caktuar. Konfirmimin e termineve do e merrni si dhe një rikujtesë përmes një mesazhi.

Ku merret vaksina?

Në Hamar vaksinimi bëhet në Vikingskipet, Åkersvikvegen 1.

A keni pyetje?

Nëse keni pyetje në lidhje me vaksinën e koronavirusit, kontaktoni mjekun familjar.

Renditja për vaksinim

Në Hamar në prill të vitit 2021 vaksinohen këto grupe:

- personat që janë 65 vjeçarë dhe më të vjetër
- personat në mes të moshës 18 dhe 64 vjeçare me sëmundje serioze

Pastaj fillon vaksinimi për:

1. Grupmosha prej 55-64 vjeçarë me sëmundje themelore
2. Grupmosha prej 45-54 vjeçarë me sëmundje themelore
3. Grupmosha prej 18-44 vjeçarë me sëmundje themelore
4. Grupmosha prej 55-64 vjeçarë
5. Grupmosha prej 45-54 vjeçarë